



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Fëmijëve



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2017
Nr. Dok. 201700505/2

Lënda: *Rekomandojmë marrjen e masave për përmirësimin e trajtimit, kushteve dhe mirërritjen e fëmijëve në Shtëpinë e Foshnjës 0-6 vjeç, Durrës.*

Drejtuar: **Z. Vagjush DAKO**
Kryetar i Bashkisë Durrës

Durrës

Znj. Etleva BISHA
Shërbimi Social Shtetëror
Drejtoreshë e Përgjithshme

TIRANË

Të nderuar!

Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në zbatim të urdhrit të Avokatit të Popullit nr. 51, datë 03.04.2017, kreu një inspektim të përgjithshëm në Shtëpinë e Foshnjës 0-6 Durrës, më datë 21.04.2017.

Pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, Avokati i Popullit ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrorë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

Shënimet paraprake

Në përmbushje të detyrave kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të të drejtave njerëzore dhe lirive themelore të fëmijëve, si dhe në bazë të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku parashikohet ndër të tjera se: "Avokati i Popullit ose persona të autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim apo autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në azile dhe veçanërisht në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër ku ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut".

“Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise”; Institucioni i Avokatit të Popullit sipas një plani vjetor inspektimesh ka kryer vizita monitoruese në Qendrat publike të përkujdesit të të miturve rezidencial në të gjithë vendin.

Objekti i inspektimit ishin trajtimi, kushtet dhe niveli i zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore të fëmijëve rezidentë në këtë institucion. Fillimisht grupi i ekspertëve kreu një takim paraprak me drejtuesen e institucionit, e cili u shpreh e gatshme për bashkëpunim në përmbushjen e qëllimit të inspektimit.

Gjatë muajit shkurt 2017, legjislacioni që mbulon këtë fushë shërbimesh ka ndryshuar me miratimin e Vendimeve nr. 106 dhe nr. 107, datë 15.02.2017, të Këshillit të Ministrave. VKM nr. 106, datë 15.02.2017 “Për një ndryshim në Vendimin Nr.425, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për Përcaktimin e Kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në Institucionet Rezidenciale, Publike dhe Jopublike, të Përkujdesjes Shoqërore”, të ndryshuar, riorganizon institucionet e përkujdesjes shoqërore publike, të cilave ju është lënë detyrë të transformojnë shërbimin brenda një periudhe 4-mujore nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ku për këtë institucion të inspektuar detyrimi i vendosjes së fëmijëve dhe periudhës së qëndrimit në këtë institucion është mosha 0-5 vjeç ku fëmijët marrin shërbime të përkujdesjes shoqëror rezidencial. Ndërsa VKM nr. 107, datë 15.02.2017, rrit kuotën mujore për fëmijët e grupmoshave 6-15 vjeç të cilët marrin një kuotë mujore 1.000 lekë dhe 16-18 vjeç 1500 lekë. Ndryshimet e kësaj VKM-je nuk preknin grupmoshën e fëmijëve të sistemuar në këtë institucion.

Trajtimi

Gjatë vizitës inspektuese u kqyrën kushtet materiale në të cilat jetojnë këto fëmijë, ambjentet e përbashkëta, dhomat e gjumit, tualetet, kuzhina, si dhe dokumentacioni i mbajtur nga stafi i institucionit në lidhje me aktivitetet që zhvillohen për këta fëmijë, kartelat mjekësore, dosjet psiko-sociale si dhe edukimi i tyre. Gjithashtu, gjatë inspektimit grupi inspektues u ndal veçanërisht në mbledhjen e të dhënave lidhur me trajtimin e tyre nga ana e stafit të këtij institucioni.

Aty trajtoheshin fëmijë nga mosha 0-6 vjeç, gjithashtu kjo qendër kryen edhe rolin e Qendrës Ditore.

Gjatë inspektimit kishte gjithsej 15 fëmijë rezidencialë, 8 prej tyre ishin të akomoduar te shtëpiza në Durrës dhe 7 në shtëpizën në Shkozë, ku kapaciteti i këtyre shtëpizave ishte për 10 fëmijë. Shtëpiza e tretë, që ndodhet në Shkozë po rikonstruktohej dhe në dijeni të stafit ajo nuk do të shërbente më si pjesë e shtëpinë së Foshnjes Durrës. Nga gjithë fëmijët e sistemuar në institucion vetëm 3 prej tyre ishin pa interesim nga prindrit. Gjatë vitit 2016 janë kryer 6 birësime, 2 kthime në familje, ndërsa për vitin 2017, deri ditën e inspektimit janë kryer 3 birësime.

Si *Qendër Ditore* kjo qendër trajtonte 22 fëmijë, ndërkohë që kapaciteti është 25 fëmijë. Frekuentimi ditor kryesisht bëhej nga fëmijë të ardhur nga familje me probleme ekonomike e për të cilët vendos pushteti vendor.

Gjatë inspektimit por edhe nga biseda me drejtuesen e institucionit na u komunikua se është vendosur sistemi i monitorimit me kamera në ambientet e institucionit. Nga ana e grupit inspektues u la si detyrë komunikimi shkresor me Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për të patur një rregullim sa më të plotë ligjor dhe procedural duke përfshirë këtu dhe administrimin dhe menaxhimin e sistemit të monitorimit me kamera.

Ky Institucion ka varësi të dyfishtë: nga Bashkia Durrës, e cila emëron stafin dhe nga Shërbimi Social Shtetëror i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, që akordon fonde nga buxheti i shtetit.

Ishte hartuar rregullorja e re e institucionit por pritej miratimi i saj nga Kryetari i Bashkisë Durrës.

Nga ana e përfaqësuesve të Sektorit Social u ngrit si shqetësim marrëdhënia me psikologun e Maternitetit të Durrësit, për të cilën nga ana jonë do të ketë një hetim të çështjes lidhur me bashkërendimin e punëve dhe bashkëpunimin ndërinstitutional duke patur parasysh interesin më të lartë të fëmijës.

Personeli dhe kualifikimet e tij

Personeli i këtij Institucioni përbëhej nga 28 punonjës nga të cilët:

1 drejtues, 1 financier, 1 përgjegjës sektori social, 2 specialist sektori social, 19 kujdestarë (1 nga kujdestarët kryente rolin e infermierit), 2 kuzhinierë, 1 punëtor mirëmbajtje, dhe 1 sanitar. Me problemet psiko-sociale merren vetëm 2 punonjës socialë. Në krahasim me një vit më parë, pas ngjarjes së dhunë në shtëpizën e Durrësit, nga ku u larguan nga detyra një kujdestare dhe një punonjës social, janë plotësuar nga ana e bashkisë këto dy vende vakante. Ky institucion kishte 1 mjek me kohë të pjesshme, që paraqitej në qendër çdo ditë, i cili paguhet nga Bashkia Durrës.

Për më tepër, Organika e miratuar me Urdhër të Kryeministrit, për institucionin e mësipërm rezidencial nuk është në përputhje me paketën e Standardeve dhe Procedurave për institucionet rezidenciale publike dhe jo-publike që shërben si udhëzues për të gjithë mënyrën e funksionimit dhe vlerësimit të punës së qendrave, ku edhe përcaktohen qartësisht specialitetet dhe standardi punonjës për numër fëmijësh. Sipas paketës së standardeve për këtë institucion, duhet të kishte:

1-10 fëmijë-1 punonjës social

1-20 fëmijë-1 pediatër

1-20 fëmijë-1 psikolog

1-5 fëmijë- 1 edukator

1-10 fëmijë- 1 infermier

1-5 fëmijë- 1 kujdestar

Ky institucion nuk ka psikolog.

Nga ana e Sektorit të Kujdesit Social na u dorëzuan kopje të zhvillimit të moduleve të trajnimit kundër dhunës dhe abuzimit me fëmijët, por nga monitorimi në vend sidomos i shtëpizës së Durrësit, më shumë trajnime duhet të zhvillohen për stafin nga ana e SHSSH.

Organika e këtij institucioni për sektorin e kujdesit shëndetësor ishte e plotësuar me një njeke me kohë të pjesshme, neuropediatre në spitalin rajonal Durrës, por mungonte ndihmësmjekja. Një nga kujdestaret me arsim të lartë “Infermieri”, me urdhër të brendshëm të drejtoreshës kryen detyrat e ndihmësmjekut.

Sa i përket punonjësit të shërbimit (rojës), bëhet vetëm gjatë natës dhe jo për pjesën tjetër të ditës pasi fondi është i limituar. Gjatë pjesës tjetër të ditës shërbim e kryejnë vetë punonjësit e qendrës.

Kushtet materiale

Ngrohja në këtë qendër realizohej me kondicionerë dhe ngrohëse.

Kuota ditore ushqimore, për fëmijët ditorë rezidencialë ishte 290 lekë në ditë, për fëmijët rezidencialë 0-3 vjeç 300 lekë në ditë, për fëmijët 3-6 vjeç 310 lekë në ditë. Kjo kuotë konsiderohej e mjaftueshme për faktin se numri i fëmijëve ishte nën kapacitetin e institucionit dhe për shkak të donacioneve të ndryshme, ndërkohë nëse ky institucion do të kishte një kapacitet maksimal të përfituesve, kuota ditore e ushqimit do të ishte e pamjaftueshme. Për sa më sipër lind nevoja e indeksimit të kuotës financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve të fëmijëve përfitues.

Kushtet e godinave ndryshonin nga një vit më parë, pasi ishin bërë disa rregullime përsëri korridorët dhe ambientet e përbashkëta kishin lagështirë dhe ambientet e ndenjjes dhe dhomat e gjumit të fëmijëve ishin shumë të ftohta. Edhe pse Bashkia Durrës ka akorduar një fond prej 700.000 lekësh për mirëmbajtjen e shtëpizave, nevojitet jo vetëm mirëmbajtje por edhe rikonstruksion dhe ndërhyrje në disa pjesë të godinës, pasi situata aktuale e shtëpizës në Shkozet (kati i parë i saj është me lagështirë). E njëjta situatë ishte edhe në shtëpizën e Durrësit ku kishte lagështirë dhe ambiente të ftohta duke mos ofruar një shërbim të mirë për një jetesë sa më të shëndetshme të fëmijëve. Institucioni në shtëpizën funksionale në Shkozet ka një shkallë hekuri emergjence, por në fakt kjo shkallë nuk është funksionale, pasi është e pasigurt për evakuimin e fëmijëve në rast emergjent.

Gjatë inspektimit u evidentuan edhe probleme në lidhje me kontrollin e masave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpërthimi. Stafit ishte i trajnuar por bombolat e zjarrëfikseve ishin të pakolauduara, ashtu sikurse edhe bombolat e gazit që përdoren për gatim.

Përsa ju përket ambienteve të përbashkëta dhe atyre të dhomave të gjumit, ato ishin të mirëmbaljuara, të pajisura me batanije, carcafë etj. Fëmijëve nuk ju mungonin veshëmbajtjet si dhe produktet hotelerike, kjo edhe për faktin se përveç blerjeve të bëra nga institucioni kishte dhe donacione të ndryshme.

Kuzhina e institucionit gatonte vetëm për fëmijët me frekuentim ditor të saj. Për fëmijët e tjerë gatuhej në shtëpiza. Menuja javore ishte e afishuar. Kuzhinierja ishte e pajisur me librezë shëndetësore dhe kampionët e ushqimit ruheshin në frigorifer. Në kuzhinë punonte një person i cili mbante dhe celësin e saj.

Në ambientet e Institucionit ishin të afishuara të drejtat e fëmijëve, dhe ekzistonte kutia e ankesave e cila ishte me çelës dhe hapej një herë në muaj me komision nga përfaqësuesja e sektorit social të Bashkisë Durrës.

Fëmijët vizitoheshin si dhe takoheshin rregullisht nga të afërmit duke u monitoruar nga personeli i qendrës, duke bërë shënimin përkatës në librin e takimeve. Dhoma e takimeve me prindërit apo të afërmit ishte e papërshtatshme për realizimin e tyre duke qenë shumë e madhe dhe mungonin orendi për ta bërë sa më të përshtatshme për fëmijët. Gjithashtu në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të MMSR ky institucion kishte marrë masa për krijimin e dhomës së emergjencës e cila nuk ishte e përshtatshme për vendosjen e fëmijëve të sjellë në situatë emergjente në këtë institucion. Dhoma e emergjencës, ishte një ambient me një krevat para njëres prej dhomave të gjumit të fëmijëve, gjë që e bënte të papërshtatshëm pozicionimin dhe funksionimin e saj pasi për të kaluar në dhomën e gjumit të fëmijëve duhet të kaloje nga ky ambient.

Monitorimi i standardeve në këtë qendër kryhej nga Shërbimi Social Shtetëror, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale, si dhe inspektime nga Bashkia Durrës.

Të gjithë fëmijët ishin të pajisur me kartela vaksinimi dhe karta shëndeti.

Vaksinimi i fëmijëve në këtë institucion kryhej rregullisht sipas kalendarit të vaksinave dhe grup moshave të përcaktuara në të.

Në këtë institucion nuk kishte fëmijë me sëmundje kronike por për të gjithë fëmijët që herë pas here kishin nevojë për trajtim medikamentoz, nuk zbatoheshin receta të rimbursueshme, por ilaçet siguroheshin me anë të një fondi financiar të posaçëm të institucionit të planifikuar në çdo fillim viti. Në këto raste fëmija shoqërohej për te mjeku i lagjes.

Kontrollet periodike mjekësore kryheshin rregullisht, si dhe ecuria e zhvillimit psikomotor të fëmijëve ishte e dokumentuar.

Edukimi dhe aktivitetet

Ky institucion zhvillonte aktivitete të ndryshme me fëmijët brenda dhe jashtë tij. Plani i aktiviteteve ishte mujor dhe shumë prej aktiviteteve ishin të dokumentuara si psh ditëlindjet e fëmijëve, shëtitjet jashtë në qytet, shoqërimi të këndet e lojërave dhe gjatë sezonit të plazhit, shoqërimi i tyre në plazh.

Nga kontrolli i dosjeve të përfituesve, plotësimi i RVNE-ve dhe FID-it, nuk ishte i plotë dhe në përputhje me standardet. Ky është një fenomen i hasur në të gjitha institucionet që ofrojnë këtë shërbim duke bërë që një plotësim i tillë të mos nxjerrë në pah progresin dhe regresin e fëmijës duke specifikuar konkretisht treguesit që ka fëmija, ndërkohë që është për tu vlerësuar plotësimi dhe ndjekja e Planeve të Largimit të fëmijëve.

Gjatë monitorimit të shtëpizës së Durrësit, u kontaktua me punonjësen sociale dhe kujdestaren e turnit përkatës. U monitoruan ambientet, ndërkohë që fëmijët ishin në gjumë. Nga ana e grupit monitorues u kontrollua dokumentacioni që ndodhej në këtë shtëpizë, si procesverbalet e incidenteve të ndodhura, ku iu kushtua vëmendje e veçantë dy rasteve, rastit të fëmijës me inicialet K. Ç, i dhunuar nga kujdestarja në këtë shtëpizë një vit më parë dhe rasti i një fëmije me inicialet S. K që përdorte dhunë ndaj fëmijëve të tjerë, bullizëm (kafshim). Nga grupi monitorues punonjëses sociale Vilma Hoxha iu kërkuan planet e kujdesit social të këtyre përfituesve, e cila na tha se gjithë dokumentacionin e mbante te zyrat në Shkozë, edhe pse kanë detyrimin të mbajnë një kopje të dokumentacionit në këtë shtëpizë, për të plotësuar rubrikat përkatëse nga

kujdestaret dhe punonjësja sociale për të ndjekur treguesit konkret për realizimin e objektivave të përcaktuar në këtë plan për çdo fëmijë. Punonjësja sociale iu kërkua informacion se çfarë shërbimesh të specializuara janë ofruar për fëmijën me inicialet K. Ç pas ushtrimit të dhunës fizike të ushtruar nga punonjësja e institucionit. Nga informacioni i dhënë nga punonjësja sociale u informuam se ky fëmijë ka marrë shërbime të specializuara nga psikologe Erjola Dajlanaj. Nga kontrolli i dokumentacionit për të konstatuar shërbimet konkrete ofruar fëmijës, rezultoi se psikologjia ka bërë një raport vlerësimi për situatën e fëmijës ku ka evidentuar që *vetëm gjatë kontaktit të parë fëmija është treguar tërheqës, shmangës dhe ka pasur reagime fobike. Por këto sjellje i ka justifikuar me faktin që psikologjia ishte një figurë e panjohur për fëmijën dhe ishte e vështirë të krijoje marrëdhënie ndër personale por në vazhdimësi marrëdhënia atashuese ka qenë normale.* Nga ky raport pavarësisht se është realizuar për fëmijën me inicialet K.Ç janë lënë rekomandime specifike për punën që edukatorët duhet të realizonin me fëmijët dhe punonjësit social por asnjë gjë konkrete mbi punën që duhet të realizonte stafi nuk është bërë.

Nga intervista që zhvilluam me punonjësën sociale, e cila fillimisht ishte shumë konfuze për rastin e fëmijës S. K, (një herë tha se rasti nuk është përsëritur më, nga ana tjetër që është fëmija i tillë, kemi bërë këshillime) por kur iu kërkua plani i përkujdesjes se çfarë është bërë për mos tu përsëritur si rast, tha se nuk e dispononte pasi gjithë dok ishte në Shkozë. Për sa më sipër, punonjësi social edhe pse ka një vit punë në këtë institucion, nuk i njeh mirë detyrat funksionale që duhet të kryej, edhe pse nga dokumentacioni që na është vënë në dispozicion rezulton se është trajnuar pikërisht për këtë çështje.

Gjithashtu nga ana e punonjësës sociale na u komunikua se 5 nga 8 fëmijët në këtë qendër frekuentonin kopshtin “Foto Monobeu”.

Avokati i Popullit gjykon se krijimi i kushteve të përshtatshme të jetës e zhvillimit të këtyre fëmijëve duhet të jetë i një rëndësie të veçantë, nisur dhe nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, kjo në funksion të garantimit të rritjes së tyre me dinjitet e në mënyrën më të mirë të mundshme, duke gëzuar plotësisht të drejtat e tyre themelore.

Në mënyrë që Shtëpia e Fëmijës Durrës, si institucion i përkujdesit publik rezidencial për fëmijët 0-6 vjeç të plotësojë standardet e shërbimit të përkujdesit shoqëror për fëmijët në Institucionet Rezidenciale, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

REKOMANDOJMË

1. *Marrjen e masave urgjente kur konstatohet se ndaj fëmijëve është ushtruar dhunë jo vetëm nga stafi por edhe fëmijët ndaj njëri-tjetri “bullizmi”, për evidentimin dhe pasqyrimin e sjelljeve të tyre në RVNE-të e cila duhet të konkretizohet me objektiva specifike për rehabilitimin e sjelljes në planet e përkujdesit individual për çdo fëmijë.*

2. *Marrjen e masave për thjeshtëzimin dhe përshtatjen me moshën e përfituesve të Formularit FID dhe RVNE në përmbushje të standarteve.*
3. *Marrjen e masave nga Bashkia Durrës për miratimin e Rregullores së funksionimit dhe organizimit të institucionit.*
4. *Marrjen e masave për plotësimin e strukturës së institucionit me Psikolog dhe ndihmësmjek dhe kujdestare.*
5. *Marrjen e masave për tërheqjen e vëmendjes ose dhënien e një mase disiplinore ndaj punonjësës sociale të Shtëpizës Durrës për moszbatim të detyrave funksionale të saj.*
6. *Marrjen e masave për trajnimin e stafit për parandalimin e çdo forme dhune ndaj fëmijëve.*
7. *Marrjen e masave për indeksimin e kuotës financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve të fëmijëve përfitues nga ky institucion.*
8. *Marrja e masave për rikonstruksionin e pjesëve me lagështirë të shtëpizave.*
9. *Marrjen e masave për komunikimin shkresor me Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për të patur një rregullim sa më të plotë ligjor dhe procedural duke përfshirë këtu dhe administrimin dhe menaxhimin e sistemit të monitorimit me kamera.*
10. *Marrjen e masave për përshtatjen e një ambienti tjetër në institucion si Dhomë Emergjencash.*

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”.

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe në vijimësinë e bashkëpunimit në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve.

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI